



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 374, datë 28.09.2020**

**PËR**  
**CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR ZHVILLIMIN E PROCEDIMIT**  
**DISIPLINOR NR.2/2020, TË FILLUAR NË NGARKIM TË MAGJISTRATIT {...}, ME**  
**DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN E APELIT TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 dhe vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, me propozim të Kryetarit të Komisionit Disiplinor:

**V E N D O S I:**

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor z. Dritan Hallunaj, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr.2/2020, në ngarkim të magjistratit {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...}, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**